



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13, 58 dhe 68 par 68.4 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 e datës 4 qershor 2008, si dhe neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 i datës 26.09.2008, Kryetari i Komunës merr

VENDIM
PËR FORMIMIN E KOMISIONIT PËR HARTIMIN E RREGULLORES SË RE PËR
TRANSPARENCË NË KOMUNË

Neni 1
Përbërja

Formohet Komisioni për hartimin e Rregullores së re për transparencë në Komunë, (në vazhdim të tekstit Komisioni) në këtë përbërje:

- 1.Fauz Xhemajli , Drejtor i Drejtoratit për Administratë, Kryesues
- 2.Behar Krasniqi, Sektori për përfaqësim dhe çështje ligjore, anëtar
- 3.Ylber Reqica, OJQ- Polis, anëtar

Neni 2
Detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit

Detyrë e Komisionit është që në pajtim me dispozitat e nenit 68 par 68.4 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dhe dispozitave tjera ligjore përkatëse të hartojë Projektin e Rregullores së re për transparencë më së largu me datë 25.04.2017.

Neni 3
Hyrja në fuqi

Vendimi hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëjtin do të njoftohet Kryesuesi dhe anëtarët e Komisionit .

1Nr. 034-14898
Lipjan, më 24.03.2017



KRYETARI I KOMUNËS
Imri Ahmeti

(Handwritten signature)